




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

03 -11- 2020

Ref. 2011/834/KPM/xhl

KUMANOVA CABLE
Bashkim LUMI
Drejtör
Therandë

VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2020/23 Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër
KUMANOVA CABLE (Palë Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 12 dhjetor 2019 e ka sanksionuar me Vërejtje Palën Përgjegjëse dhe i ka kërkuar që menjëherë ta heq nga ritransmetimi kanalën ALSAT M, në mënyrë që të vepronte në pajtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.
3. KPM, përmes një shkrese me datën 4 shkurt 2020, ka kërkuar sërish nga Pala Përgjegjëse që ta zbatojë Vendimin duke e larguar nga ritransmetimi kanalën ALSAT M për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KPM 2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.
4. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Rregulloren KPM-2016/01, ka realizuar një monitorim në terren dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM 2016/01.
5. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit të datës 19 shkurt 2020 dhe nga të gjeturat e terrenit, ka konstatuar se Pala Përgjegjëse nuk e ka funksional kanalën informues, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 3 mars 2020, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe e

ka udhëzuar që pas pranimit të kësaj letre, ta vendosë kanalin informues për të vepruar në pajtim me nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

7. KPM, për të verifikuar sërish pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Rregulloren KPM-2016/01, ka realizuar një monitorim në terren dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 10 qershor 2020, ka gjetur se Pala Përgjegjëse sërish nuk e ka në dispozicion kanalin informues edhe pas kërkesës së dërguar, si dhe është gjetur duke e ritransmetuar kanalin ALSAT M për të cilin kanal nuk posedon marrëveshje valide për ritransmetim, duke vepruar kështu në kundërshtim me Rregulloren KPM-2016/01.

Analiza Ligjore

8. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe nenit 12 paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale”.

9. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, duke transmetuar pa marrëveshje valide kanalin ALSAT M.

Neni 12, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari duhet të krijojë një “kanal informues” i cili, duhet të përdoret vetëm për komunikim me përdoruesit dhe informim të tyre”.

10. KPM, gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka pasur në dispozicion as kanalin informues, që bazuar në nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, është obligim që duhet çdo operator ta ketë në listën e kanaleve kanalin informues që përdoret për komunikim me përdoruesit dhe për informim të tyre.
11. Komisioni i KPM-së konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të marr hapat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1 dhe nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Vendim

12. Urdhërohet Pala Përgjegjëse që të ndërpresë menjëherë ritransmetimin e kanalit ALSAT M, duke e hequr nga lista e kanaleve si dhe ta vë në dispozicion kanalin informues në mënyrë që të veprojnë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01.


13. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumë prej dymijë (2,000) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, nenit 12 paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
14. Nëse Pala Përgjegjëse, edhe pas pranimit të këtij Vendimi nuk e heq nga ritransmetimi kanalën ALSAT M dhe nuk e vë në funksion kanalën informues ashtu siç përcaktohet me Rregulloren KPM-2016/01, Komisioni do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse, në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

15. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Ekzekutimi i Vendimit

17. Ankesa e parashtruar kundër këtij vendimi nuk e pengon ekzekutimin e tij dhe se ky vendim bëhet i plotfuqishëm në momentin e pranimit nga Pala Përgjegjëse, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2, pika 2 të Ligjit të KPM-së.


Xhevat LATIFI
Kryetar



30.10.2020
Datë